



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
RAPORT TEKNIK

**HARTIMI I PROJEKTIT: OBJEKTI: STUDIM-
PROJEKTIM "RIVATILIZIM I PROJEKTIT "RRUGA E
BREGDETIT FAZA - I", BASHKIA KAVAJË.**

PROJEKTUES:

Shoqëria FTA Studio shpk

Rr. Haziz DELIU

Ndertesha 5 Hyrja B Ap .9

Tirane – Shqiperi

Tel: +355 69 56 47 337

Email: ftastudio@yahoo.com

Email: fejzotarba@gmail.com



Tiranë-Albania

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1.1 HYRJE**
- 1.2 POZICIONI I OBJEKTIT**
- 1.3 GJENDJA EKZISTUESE**
- 1.4 PROJEKT-ZBATIMI**

1.1. HYRJE

a) Situata aktuale ne vend

Shqiperia ndodhet ne jug-lindje te Europes dhe ka siperfaqe 28,748 km², duke u kufizuar nga Mali I Zi dhe Kosova ne veri, ish Jugosllavia dhe Republika e Maqedonise ne lindje dhe Greqia ne jug. Shqiperia shtrihet ne brigjet lindore te detit Adriatik, perballe me Italine.

Gjatesia e pergjithshme e kufirit shqiptar eshte rreth 1.094 km. Kufijte tokesore, detare, liqenore dhe lumore jane perkatesisht :657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare ka gjatesi 427 km, ku 273 km i perkasin bregdetit te Adriatikut dhe 154 km bregdetit Jonian. Vendi ka nje popullsi afersisht 2.895.947 banore prej te cileve mbi rreth 800,000 jetojne ne kryeqytet. Rreth 70% e Shqiperise eshte malore dhe pjesa tjeter fushore dhe kodrinore. Rajoni bregdetar ka nje klime te bute, por ne brendesi, sidomos ne veri, klima karakterizohet nga dimri i ashper dhe vera e nxehte.

Shqiperia mbetet nje vend ne zhvillim brenda Europes dhe si e tille po perballet me sfiden e zhvillimit te infrastruktures. Investimet ne transport filluan ne shkalle shume te gjere kryesisht ne fund te viteve 90'. Migrimi kaotik i popullsise drejt kryeqytetit solli si rezultat nje infrastrukture dhe sherbim publik te mbingarkuar. Ne kete kontekst ne Shqiperi jane implementuar dhe vazhdojne te implementohen programe te gjera per permiresimin dhe zgjerimin e infrastruktures, qe perfshin nje numer te madh projektesh ndertimisi Korridorit Veri – Jug dhe Lindje - Perendim.

Pozicioni gjeografik i Shqiperise e ben ate korridor trafiku potencial per rajonin e Ballkanit. Ne Shqiperi operon:

- **Transporti ajror civil nderkombetar:** forma me e pershtatshme per te hyre ne Shqiperi eshte nga ajri nepermjet Aeroportit te Rinasit, qe ndodhet rreth 15 km nga Tirana. Ka fluturime ditore nga nje numer kompanish ajore Europiane nga shume qytete brenda Europes.

Rruga afer aeroportit te Rinasit u rehabilitua nga forcat e NATOs gjate luftes ne Kosove.

Rruga nga aeroporti "Nene Teresa" deri ne nyjen e Kasharit u rehabilitua ne 2005 nga operatori Gjerman i aeroportit

- **Transporti Hekurudhor:** Gjatesia e rrjetit hekurudhor ne funksionim eshte rreth 409 km. Transporti hekurudhor ne 2014 ka pesuar nje renie te volumit te punes per pasagjere dhe mallra, krahasuar me vitin 1990. Kryesisht kjo ka ardhur si rezultat i

konkurences nga transporti rrugor, por gjithashtu si rezultat I kushteve te keqija te infrastruktures ne kete lloj transporti.

- **Transporti Detar:** Ky lloj transporti aktualisht kryhet nepermjet 4 porteve: Durresi, Vlora, Saranda dhe Shengjini. Sherbimi I trageteve me Italine operon nga porti I Durresit dhe Vlores. Gjithashtu nje traget operon ndermjet ishullit grek te Korfuzit dhe Sarandes. Porti me I rendesishem eshte ai I Durresit, I cili sherben gjithashtu si porte hyrese e korridorit VIII per Shqiperine dhe vazhdon drejt kufirit maqedonas.

b) Informacion i Pergjithshem

Forma me e perdorur e transportit ne Shqiperi eshte transporti rrugor. Gjatesia e pergjithshme e rrjetit rrugor ne Shqiperi eshte rreth 18,000 km. Ky rrjet perfshin 3,636 km rruge nacionale dhe rreth 10,500 km rruge lokale. Pjesa e mbetur prej 4000 km eshte nen juridiksionin e subjekteve dhe kompaniveprivate, etj.

Rrjeti kombetar perbehet nga:

- **Rjeti Rrugor Primar**, i cili ka nje gjatesi prej rreth 1 198 km dhe ka 9 nderlidhje kryesore qe perbejne rrjetin baze;
- **Rrjeti Sekondar** I cili ka nje gjatesi prej rreth 2083 km

Rruget ne rrjetin primar dhe 67% e rrjetit sekondar jane rruge te asfaltuara. Rreth 48% e gjatesise se pergjithshme te rrjetit primar kalon ne terren te sheshte dhe 56% e rrugëve ne rrjetin sekondar kalon ne terren malor.

Komponentet kryesore te rrjetit rrugor kombetar ne Shqiperi jane:

- **Korridori Veri-Jug** ka nje gjatesitotale prej 374 km (me nje shtrirje nga Hani i Hotit deri ne Gjirokaster), dhe perfshin seksionet rrugore:

Shkoder – Hani I Hotit

Lezhe – Shkoder

Lezhe – Milet

Milot – Mamurras (ky segment eshte gjithashtu pjese e korridorit Durres – Morine)

Mamurras – Fushe – Kruje (ky segment eshte gjithashtu pjese e korridorit Durres – Morine)

- **Fushe Kruje – Vore – Rrogozhine (66 km)** (ky segment eshte gjithashtu pjese e korridorit Durres – Morine)

Rrogozhine – Lushnje

Lushnje – Fier

Fier – Tepelene

Tepelene – Gjirokaster

- **Korridori Lindje-Perendim** eshte pjese e korridoritVIII qe kalon nga portet e Durresit dhe Vlores deri ne kufi me Maqedonine, duke perfunduar ne Qaf Thane. Seksionet qe perfshihen ne kete korridor jane:

Durres – Rrogozhine (ky seksion eshte gjithashtu pjese e korridorit Veri - Jug)

Rrogozhine – Elbasan

Elbasan – Librazhd

Librazhd – Qukes

Qukes – Qafe Thane

- **Korridori rrugor ndermjet Durrës dhe Morinës**

Ndërtimi i superstradës Durrës – Morinë deri në kufi me Kosovën, lidh Shqipërinë me korridorin X dhe Serbinë. Segmentet që përfshihen këtu janë:

Seksioni Durrës – Milot (ky seksion është gjithashtu pjesë e korridorit Veri - Jug)

Seksioni Milot – Rreshen

Seksioni Rreshen – Kalimash

Seksioni i tretë që kalon nga Kalimash deri në Kukës përfundon në pikën kufitare të Morinës.

c) Sistemi Institucional dhe Kuadri Ligjor

Ministria e Transportit dhe Infrastruktës është mbikqyresë kryesore e transportit rrugor në Shqipëri. Qeveria shqiptare dhe Ministria po ndërmarrin veprime ligjore për reformimin në sektorë të ndryshëm të transportit.

Ministria e Transportit dhe Infrastruktës, nëpërmjet ARRSH, menaxhon sektorin e transportit rrugor për rrjetin rrugor kombëtar. Konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me Strukturat e Autoriteteve Lokale (Komuna, Bashki, Qarqe) në ato teritore ku do të kalojë rruga e re, me institucionet që merren me çështjet mjedisore (Drejtoret Rajonale Mjedisore, Agjensitë Mjedisore, Drejtoret Rajonale të Pyjeve), me Institutin Arkeologjik dhe ato të Monumenteve të Kulturës, si edhe me subjekte të tjera që tregojnë interes për projektin. Konsulenti do të bashkëpunojë me këto institucione për të siguruar informacion sa më aktual me qëllim prezantimin e alternativave me të përshtatshme, për plotësimin me elementet e nevojshëm të infrastruktës, për plotësimin e dokumentacionit të shpronësimeve dhe marrjen e miratimeve ligjore nga autoritetet përkatëse, etj. Për këtë, Konsulenti do të mbështetet në studimet dhe planet urbanistike të Bashkive dhe Komunave ku do të kalojë projekti. Siguria rrugore është përgjegjësi që shpërndahet në disa ministri nëpërmjet Komitetit Nderministror që drejtohet nga Kryeministri.

Sistemi ligjor i tanishëm bazohet në 3 ligje dhe disa akte nënligjore:

- Ligji Nr. 8308/ 1998 për Transportin Rrugor, i cili rregullon kushtet dhe menyrat se si do të kryhet transporti i pasagjerëve dhe mallrave në transportin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- “Rregulloret e miratuara për pranimin e operatorëve që mundësojnë transportin për pasagjerë dhe mallra, kohët e udhëtimit, të finalizuara në një dokument zyrtar që është aprovuar me Vendimin nr.1243/2008.
- Ligji për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë Nr. 8378/1998, ku përcaktohen kategoritë e rrugëve, institucionet përgjegjëse për kontrollin rrugor, maksimumi i dimensioneve dhe peshës së lejuar të automjeteve
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 153/ 2000 për aplikimin e Rregullores dhe aplikimin e Kodit Rrugor Shqiptar.
- VKM Nr.628, datë 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve".
- Udhezuesi I MTPP Nr 2/2010 “Kontrolli Teknik i automjeteve”
- Ligji për ARrSH Nr. 10164/ 2009.
- Nr.10164/ 2009.
- Rregullorja e re për Standardet e Projektimit datë 30/07/2015.

1.2. Qellimi i Punes dhe Objektivat e Studimit

Bashkia Kavaje ka planifikuar hartimin e projekt-zbatimit te objektit Studim-Projektim "Rivitalizim i Projektit "Rruga e Bregdetit Faza - I", Bashkia Kavajë.

Bazuar ne detyren e projektimit dhe kerkesat e Investitorit, nga ana jone si shoqeri projektuese eshte pergatitur materiali i nevojshem teknik per projekt-zbatimin e infrastruktures rrugore.

Objekti ne studim ndodhet brenda territorit te Bashkise Kavaje dhe eshte rruga hyrese ne zonen veriore te qytetit Kavaje nga autostrada Durres - Rrogozhine. Objekti nis ne rrethrotullimin e kryqezimit me Autostraden "Durres - Rrogozhine" dhe perfundon ne rrethrotullimin e kryqezimit me rrugen "Taulantia" dhe shetitoren "Josif Budo".

Kjo rruge ka nje gjatesi totale prej 1377ml.



Horografia e Rruges

1.3. GJENDJA EKZISTUESE

Kjo rruge eshte me rëndësi te madhe pasi lidh veriun e qytetit te Kavajes me autostraden Durrës - Rrogozhinë, drejt qyteteve te Durrësit, Tiranës dhe pjesës veriore te vendit.

Gjendja ekzistuese e rruges nuk eshte e mire, me shtresa ekzistuese te cilat kane vlezime gjatesore dhe terthore, cedime pergjate korsise. Bazuar ne raportin gjeologjik si dhe gropave-test te hapura pergjate rruges ne te dy anet e asaj konstatohet bazament i dobet, shtresa jo uniforme, granulometria e shtresave jo e rregullt, perzierje e shtresave suargjilore me shtresen e kalldrimit ekzistueset.

Rruga ekzistuese eshte e ndare ne dy karrexhata me nje brez te gjelberuar me gjerësi rreth 1m. Secila karrexhate ka 2 korsile levizëje me gjerësi 3.25m secila, nje kune betoni me gjerësi 0.5m dhe trotuar me gjerësi qe varion rreth 1.6-2m.



Foto te Gjendjes Ekzistuese

1.4. PROJEKT-ZBATIMI

Bazuar ne detyren e projektimit te hartuar nga Investitori nga ana jone si shoqeri projektuese eshte pergatitur materiali i nevojshem teknik per hartimin e Projekt-Zbatimit per rindertimin e rruges hyrese Kavaje veri, Studim-Projektim "Rivatilizim i Projektit "Rruga e Bregdetit Faza - I", Bashkia Kavajë.

Ne projekt zbatimi eshte parashikuar ndertimi i rruges kryesore me gjatesi 1377ml, neper te cilen do te kaloje trafiku i zones perreth.

Gjate zgjidhjes se dhene teknike eshte patur ne konsiderate ndertimi i nje segmenti rrugor i cili te sherbeje per perballimin e levizjeve ne kete zone, duke u pershtatur me pozicionet planimetrike te objekteve qe e konturojne.

Ne projekt-zbatimi eshte parashikuar te ruhet gjurma e rruges ekzistuese. Ne krahun e majte te rruges (dalja nga qyteti) trotuari dhe korsite do te rindertohen ne pozicionin aktual. Trafikndaresi do te eliminohet dhe rruga do te behet me nje karrexhate te vetme. Ne krahun e djathte te rruges do te eliminohet njera nga korsite hyrese ne qytet dhe do te zevendesohet me nje korsi bicikletash dhe nje brez te gjelberuar.

Nga ana altimetrike jemi munduar te bejme permisimet perkatese teknike, brenda kufinjve te lejuar edhe nga pikpamja e kostove perkatese. Eshte synuar qe niveleta e re te permisoje pjerresite ekzistuese por edhe duke respektuar kuotat e hyrjeve te objekteve ekzistuese si dhe rakordimet ne kuote me rruget ekzistuese.

Duke patur parasysh qe rruga kalon ne njere zone pothuajse te ezauruar nga ana urbane, eshte patur parasysh ruajtja e nivelit ekzistues te rruges, duke mos sjelle diferenca kuote ne lidhje me hyrjet e apartamenteve apo rezidencave.

Gjithashtu, per sa i perket prishjeve, nuk jane parashikuar prishje objektesh. Trotualet anesore do te perfundojne ne kufijte aktual dhe do te kete vetem prishje te mureve rrethues ekzistues, te cilet do te rindertohen.

Sipas diskutimeve, eshte parashikuar qe rruga te kete nje gjeresi totale asfalti 9.75m e ndare ne 3 korsi prej 3.25m secila, nje korsi hyrese ne qytet dhe dy korsi dalese. Ne te dy anet e rruges do te kete kuneta me pllaka guri dhe gjeresi 0.5m. rruga do te konturohet ne te dy anet me me bordura guri dhe parrake metalik dekorative. Ne krahun e majte te rruges (ana lindore) do te ndertohet trotuar ne pozicionin e trotuarit aktual, me gjeresi qe varion rreth 1.6-2m. Ne krahun e djathte te rruges (ana perendimore) do te ndertohet nje korsi biciklete me gjeresi 2.2m, nje brez i gjelberuar me gjeresi 1.1m dhe nje trotuar me gjeresi qe varion rreth 1.6-2.5m.

Ne kete projekt jane parashikuar ndertimi i mureve rrethues ne te dy anet e rruges.

Muret rrethues jane parashikuar beton/arme C 20/25 me ngjyre dhe me lartesi mesatare 1.6m mbi nivelin e trotuarit.

Ne projekt-zbatim eshte parashikuar vendosja e shtresave te reja rrugore si me poshte:

- Asfaltobeton - 4 cm
- Binder - 6 cm
- Konglomerat - 10 cm
- Stabilizant - 20 cm (0-32 mm)
- Çakëll - 30cm (5-63 mm)
- Mbushje me Çakëll - 60cm (10-100 mm)
- Gjeotekstil


Shtresat e trotuarit jane si me poshte:

- Shtrese betoni C 25/30 me guralec me ngjyre - 20 cm
- Shtrese Stabilizant - 10 cm
- Mbushje me Çakëll - 50cm

Shtresat e korsise se bicikletave jane si meposhte:

- Shtrese binderi me ngjyre 4cm
- Shtrese stabilizanti 10cm
- Mbushje me Çakëll 50cm

Profili Terthor Tip



- **RRJETI KUSH dhe KUZ**

Konceptimi i rrjetit te kanalizimeve eshte bere duke ruajtur parimin e ndarjes se ujerave te zeza nga ato te bardha.

Pergjate te dy aneve te rruges nuk ka sistem te kanalizimit te ujrave te zeza (KUZ), per kte arsye me kerkese te Bashkise Kavaje eshte parashikuar sistem i ri kanalizimi (KUZ) ne te dy anet e rruges, pergjate trotuarit te anes se djathte dhe te majte me tuba te brinjezuar hdpe 250mm.

Sistemi i largimit te ujerave te bardha KUSH eshte konceptuar kryesisht me vendosjen e tubave te brinjezuar hdpe dhe ndertimin e pusetave te shiut per largimin e ujerave te bardha ne trupit te rruges.

Ne Projekt-zbatimi eshte parashikuar realizimi i rrjetit te ri te KUSH ne anen e djathte dhe te majte te rruges.

Projekt-zbatimi parashikon vendosjen e linjes me tuba HDPE te brinjezuar me diameter 315mm dhe 400mm. E gjithe sasia e ujrave siperfaqesor mblidhet nga pusetat e reja b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize.

Shkarkimi i linjave te KUSH do te kryhet ne perroin e Lishatit.



Planimetria e KUSH

- **NDRICIMI RRUGOR + LINJAT REZERVE**

Ne projekt eshte parashikuar ndertimi i ndricimit te ri rrugor. Linja e ndricimit do te vendoset ne te dy anet e rruges. Shtyllat e ndricimit jane me lartesi mbi toke 8m (0.8m te inkastruara), me dy dege ne nivele te ndryshme dhe vendosen cdo 20m. Ndriculesit do te jene LED 90W dhe LED 30W. Ne anen e majte ndricuesit do te jene me dy dege por krahe me te vogel, ndersa ne anen e djathte do te jene me dy dege por krahu do te jete 1.5m ose me i madh ne varesi dhe te modelit.

Furnizimi me energji do te behet nga kabina ekzistuese.

Ne projekt eshte parashikuar vendosja e linjave rezerve. Linjat jane te vendosura nen trotuare, 4 tuba me diameter 100mm ne secilen ane te rruges.

Ne intersektimet e rrugeve apo aty ku linja kalon ne gjurmen e rruges, tubat plastike futen ne tubacione metalike D=140 mm, kjo per mbrojtjen e tubave nga demtimi i presionit te mjeteve. Do te vendosen puseta 100x100cm cdo 50m larg njera tjetres.



Planimetria e Ndricimit Rrugor

- **SINJALISTIKA RRUGORE**

Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu vendosja dhe realizimi i sinjalistikes perkatese horizontale dhe vertikale, ne perputhje me Kodin Rrugor, Rregulloren e Kodit Rrugor dhe Manualeve ne fuqi.

Rruga eshte paisur me te gjithe vijeimin e duhur gjatesore, ky vijezim eshte parashikuar te jete bikomponent sprajt me gjeresi 15cm dhe 10cm.

Gjithashtu eshte parashikuar vendosja e vizimit perkates per kalimin e kembesoreve, me boje bikomponent paste.

Persa i perket sinjalistikes vertikale ne projekt, aty ku eshte e nevojshme, eshte parashikuar vendosja e tabelave vertikale rrethore, katrore, trekendore, tabeleve STOP si edhe sinjaleve te drejtimit.

Ne dy anet e rruges eshte parashikuar te vendoset parmak metalik dekorativ.



Planimetria e Sinjalistikes

- **GJELBERIM**

Ne projekt-zbatimi eshte parashikuar vendosja e gjelberimit ne te gjithë gjatesine e rruges. Ne anen e majte te rruges do te vendosen ne trotuar peme dekorative cdo 6m-9m. Ne anen e djathte te rruges, midis korsise se bicikletave dhe trotuarit, do te ndertohet nje brez i gjelberuar (shkurre dekorative) me gjeresi 1.1m. Aty do te vendosen edhe peme dekorative cdo 6-9m. Pemet e parashikuara jane bli, kumbull dhe rrap.

- **TOPOGRAFIA**

Pozicioni gjeografik i Rrugeve

Nga ana jone jane kryer te gjitha rilevimet e nevojshme topografike, ne perputhje te plote me detyren e projektimit.

Per hartimin e projektit dhe per nxjerrjen e nje serie te dhenash jane shfrytezuar hartat topografike te zones ne shkallet 1:25.000 dhe 1:10.000, fotot ajrore dhe satelitore te zones si dhe matjet e drejtperdrejta ne terren.

Gjatesia totale e rruges eshte rreth rreth 1377 ml.

Instrumentat dhe metodeologjia

Zgjedhja e instrumentave dhe aparaturave

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojës se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar koordinativ (UTM 34N) me elipsoid WGS84. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS dh Stacionit Total.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne terren. Pikat e fiksuara ne terren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes.

Duke njohur tashme karakteristikat e situates urbane , e cila ne teresine e saj eshte zone me dendesi urbane te larte dhe vizualitet te kufizuar. Grupi topografik zgjodhi dhe operoi ne terren me Instrumentat mates GPS TopCon GR3 dhe Stacion Total Sokkia SRX3, si per ndertimin e rrjetit mbeshtetes dhe kompletimin e detajeve te relievit .



Foto te Instrumentave me te cilat eshte bere matja

Karakteristikat fiziko - teknike te kesaj aparature si dhe sakesite e garantuara ne percaktimin e pozicionit te pikes, se bashku me kompatibilitetin e perpunimit te te dhenave ne programet kompjuterike si edhe metodika e matjes , garantojne sakesine e kerkuar nga parametrat teknike te projektimit dhe te zbatimit.

Sistemi i referimit, ne plan, duke respektuar standartet ne fuqi, eshte zgjedhur sistemi shqipetar i pozicionimit(AlbPos).Si referenca altimetrike eshte pranuar sistemi shqipetar i nivelacionit.

Ndertimi i rrjetit mbeshtetes ne terren

Pozicionet e pikave mbeshtetese u zgjedhen pervec kriterit teknik , (ne vende te hapura dhe me shikim hapsinor te kenaqshem dhe gjatesi te pranueshme) u tregua kujdes edhe zgjedhjen e pozicioneve sipas mundesise locale dhe lehtesisht te identifikueshme si dhe strukturave te qendrueshme, kryesisht bordure trotuari, sheshe betoni , duke u fiksuar me gozhde betoni.

Bashkangjitur ketij raporti jane te gjitha materialet teknike si me poshte vijon:

- Vizatimet dhe Detajet
- Preventivi dhe Analizat e Cmimeve
- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis
- Raportin Gjeologjik
- Specifikimet Teknike
- Grafiku i Punimeve

Shoqëria "FTA Studio" shpk
Administratori

Ark.Fejzulla TARBA